



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 347 prot.

Tiranë, më 19.1. 2022

Lënda: Kualifikimi i mësuesve për vitin shkollor 2021-2022.

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

MAJ

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

Rruga "Mustafa Lleshi", Godina e Thesarit
Tiranë

Për dijeni: AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri" Nr.37
Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Aleksandër Moisiu"
Tiranë

Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 4, datë 26.02.2021 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve", Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), zhvillojnë procedurat për organizimin e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar.

1. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar të vënë në shërbim të mësuesve programet e kualifikimit të mësuesve brenda datës 28 janar 2022. Programet të shpallen edhe në faqen zyrtare të Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar.

2. Mësuesi, që kërkon të kualifikohet, plotëson kërkesën për të marrë pjesë në procedurat e kualifikimit dhe e dorëzon atë në ZVAP së bashku me portofolin profesional sipas profilit përkatës, brenda datës 15 shkurt 2022.
3. ZVAP-ja harton listat e mësuesve që do marrin pjesë në provimet e kualifikimit, së bashku me vlerësimet e portofolit (sipas formatit të ASCAP), brenda datës 28 shkurt 2022.
4. Lista e mësuesve që do marrin pjesë në provimet e kualifikimit t'u bëhet e ditur atyre deri më 3 mars 2022, në mënyrë që secili mësues të kontrollojë të dhënat dhe vlerësimet e portofolit të tij. ZVAP-ja dërgon në formë elektronike dhe zyrtare në DRAP listat e mësuesve që do marrin pjesë në kualifikim, brenda datës 7 mars 2022.
5. DRAP-ja harton listat përfundimtare të mësuesve që do marrin pjesë në provimet e kualifikimit për të gjitha ZVAP-të nën juridiksion të saj, sipas formatit të ASCAP-së dhe i dërgon në formë elektronike dhe zyrtare në ASCAP dhe në DPAP, brenda datës 10 mars 2022. Pas kësaj date nuk bëhen ndryshime në listën e mësuesve për kualifikim.
6. ASCAP-i në bashkëpunim me DPAP-në organizon dhe administron procesin e provimeve të kualifikimit, harton listën e përgjegjësve të administrimit, administratorëve dhe sekretuesve të provimit të kualifikimit sipas mjediseve dhe numrit të përcaktuar nga ASCAP-i.
7. ASCAP-i të organizon seanca informuese me DPAP-në, DRAP-et dhe ZVAP-et për procedurat e organizimit të kualifikimit të mësuesve.
8. Provimi me shkrim për kategoritë e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2021-2022, **do të zhvillohet më datën 9.04.2022, ora 10-12:30, në Tiranë,** në mjedise të përcaktuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Alqi KUSHI

